



Datë: 20.06.2025

Numër Protokolli: 4577/2025

A.nr.475/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.475/2025, të datës, 14.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimit: Komunës së Suharekës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.475/2025, e datës 14.03.2025, e parashtruar nga ankuesi A.M.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 28.02.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, lidhur me shpalljen e shpalljen e rezultatit përfundimtar në procedurën e pranimit me numër të referencë: RN00016039, për pozitën e punës „Zyrtar për Shërbime me Qytetar” në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme në Komunën e Suharekës.

A r s y e t i m

Ankuesi A.M (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 14.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1720/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00016039, për pozitën Zyrtar për Shërbime me Qytetar në Drejtorinë për Administratë i shpallur nga Komuna e Suharekës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në komunën e Suharekës, ndërsa Këshilli më datë 14.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1720/2025 të parashtruar nga ankuesi më datë 14.03.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Konkursin me numër reference RN00016039 të datës 16.12.2024; kërkesën e datës 25.07.2024; Përshkrimin e detyrave të punës; Aprovim e pozitës së lire; Vendimin për themelimin e komisionit të pranimit të datës 31.01.2025; Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit;

Vendimin e datës 13.01.2025; testin me shkrim të ankuesit dhe kandidatit fitues; përgjigjet e sakta për pyetjet me testin me shkrim; Njoftim për shpalljen e rezultatit përfundimtar i datës 28.02.2025; Renditja përfundimtar e kandidateve e datës 28.02.2025; Formulari i pyetjeve të sakta për intervistën me gojë; formularë e vlerësimit për intervistën me gojë për konditën fituese; formularin e datës 20.02.2025 për vlerësimin e eses të kandidati fitues ; Njoftim për verifikimin paraprak të datës 28.01.2025; lista e aplikonte; Lista e aplikativë të pranuar dhe të refuzuar; Aplikacionin e kandidates fituese E.H datë të aplikimit 10.01.2025 të bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit; Aplikacionin e ankuesit A.M me date të aplikimit 17.12.2024 të bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit; formularin e vlerësimit për intervistën me gojë për ankuesin A.M ;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është ***e pabazuar, sepse:***

Nga analizimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Suharekës, më datë 16.12.2024, ka shpallur Konkursin publik me numër Reference RN00016039, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime me Qytetare” në Komunën e Suharekës, me afat për aplikimi nga data 17.12.2024 deri më datë 15.01.2025.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 28 kandidatë, ndërsa kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 21 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit të kësaj procedure rekrutimi, ashtu që sipas listës përfundimtare të kandidatëve të datës 28.02.2025, është renditur i pesti në këtë listë me gjithsejtë 76.2 pikë të arritura, rrjedhimisht si kandidatë fituese ishte kandidatja E.H, e cila me gjithsejtë 97.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, sipas Njoftimit të datës 28.02.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime me Qytetare” në Komunën e Suharekës.

Ankuesi, i pa kënaqur me mos shpalljen kandidat fitues në këtë procedurë rekrutimi ka parashtruar ankesë në Këshill, duke theksuar se nuk është vlerësuar drejte në testin me shkrime dhe intervistën me gojë duke pretenduar se janë favorizuar kandidatja fituese nga anëtarët e komisioni pasi që ankuesi pretendon se ka të përfunduar edhe studimet master dhe është kandidat pre të mbrojtur tezen e doktoratës dhe nuk janë marre për bazë këto vlerësime nga ana e komisionit .

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të ankesës së ankuesit, ju referuar legjislacionit në fuqi, respektivisht Nenit 39 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht:

- Nenit 10, i cili përcakton se: 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit

të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

Andaj, Kolegji I Këshillit, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe kuadrin ligjor të lartë theksuar, ka gjetur se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, nga rrjedh se ankuesi ashtu sikurse kandidatja e përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, ku ankuesi në fazën e testimit me shkrim gjegjësisht në pyetjet me opsione ka dhënë (19) përgjigje të sakta, duke grumbulluar 38 pikë, kurse në pjesën e pyetjeve të lira në formë eseje ankuesi është vlerësuar me gjithsej 17.6 pikë nga 20 pikë maksimale, rrjedhimisht ankuesi në testin me shkrim ka arritur të grumbullojë gjithsej 55.6 pikë, ndërsa kandidatja E.H, në fazën e testimit me shkrim gjegjësisht në pyetjet me opsione ka dhënë (25) përgjigje të sakta, duke grumbulluar 50 pikë, kurse në pjesën e pyetjeve të lira në formë eseje kandidatja është vlerësuar me gjithsej 20 pikë nga 20 pikë maksimale, rrjedhimisht kandidatja E.H në testin me shkrim ka arritur të grumbullojë gjithsej 70 pikë, andaj, mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar dhe argumentuar me prova materiale, sepse me dispozitat e Nenit 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet se: 4. *Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim*, ku ankuesi si dhe kandidatja E.H kanë vazhduar me tutje duke kaluar në fazën e vlerësimit të intervistës me gojë, nga e cila intervistë ankuesi ka arritur 20.6 pikë, dhe se bazuar në formularët e vlerësimit individual të kandidatëve, rezulton se i njëjti është vlerësuar në pajtim me dispozitat e sipër theksuara, sepse ka arritur pikë maksimale nga jetëshkrimi, ngase duke qenë se posedon diplomë të studimeve bachelor ka plotësuar kriterin arsimor dhe se po ashtu posedon përvojën profesionale pas studimeve themelore në sektorin publik, ndërsa në dosjen e ankuesit nuk figuron ndonjë dëshmi që ka të përfunduar ndonjë trajnim, ashtu që me këtë rast nga provat e pranuar nga ankuesi si dhe nga organi i punësimit me asnjë dëshmi nuk është vërtetuar ndonjë parregullsi procedurale apo shkelje ligjore gjatë kësaj procedure rekrutimi, për faktin se i njëjti ka arritur 76.2 pikë të përgjithshme, duku u renditur i pesti në listën përfundimtare ndërsa kandidatja E.H, e cila nga intervista me gojë ka arritur 27.2 pikë, duke arritur gjithsej 97.2 pikë të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë e cila është shpallur kandidatë fituese.

Andaj, duke qenë se kandidatja E.H, me rastin e aplikimit në këtë konkurs ka bashkangjitur Diplomën me Nr.602/2020 të datës 11.07.2020, të lëshuar nga Kolegji AAB me të cilin dëshmon se me datë 02.07.2020, ka mbaruar studimet në programin Juridik, duke fituar kështu titullin Bachelor Juridik me Specializim në Kriminalistik, Kolegji konstaton se e njëjta plotëson kriterin arsimor dhe po ashtu posedon përvojën një vjeçare profesionale pas diplomimit të studimeve themelore, ngase sa i përket plotësimit të këtij kriteri e njëjta ka bashkangjitur Certifikatën e datës 31.01.2023 të Lëshuar Gjykata Themelore në Prizren ku dëshmohet se njëjta ka përfunduar Praktiken Gjyqësorë për periudhën 1 vjeçare nga data 01.02.2022 deri me datë 31.01.2023 në Gjykata Themelore në Prizren. Dega në Suharekë dhe mbi këtë fakt vërtetohet se kandidatja fituese e ka përmbushur edhe kriterin e provojë se punës, ndërsa ka bashkangjitur edhe certifikata e trajnimeve profesionale andaj nga shkresat e lëndës dëshmohet se e njëjta duke qenë se ka plotësuar e kriteret përkatëse të konkursit si dhe nga faza e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë ka arritur të grumbullojë gjithsej 97.2

pikë, duke u renditur e para në listën e vlerësimit të kandidatëve, e njëjta ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidate fituese, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, I cili përcakton se: 1. *Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit.* 2. *Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Duke u bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Divizioni i Burimeve Njerëzore në komunën e Suharekës me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 28.02.2025, për kandidatin fitues për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime me Qytetar* në Komunën e Suharekës ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi mbi kandidatin fitues të datës 28.02.2025, për kandidatin fitues për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime me Qytetar* në Komunën e Suharekës “siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.475/2025.

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së